



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/63-37047 dt. 20.07.2022

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **27.07.2022** (e Mërkurë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 24.06.2022.
2. Raporti Financiar Janar-Qershor 2022.
3. Propozim vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).
4. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
5. Propozim vendim për ndërrimin e statutit të Institucionit Arsimor Publik Parauniversitar-Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMPL) "Fehmi Lladrovci" të kaloj në Institucion për Arsim dhe Aftësim Profesional (IAAP)
6. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve.
7. Propozim vendim për rialokimin e mjeteve financiare nga mbetjet e projekteve kapitale brenda kategorisë.
8. Draft Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet urbane në Komunën e Drenasit.
9. Propozim vendim bartja e mjeteve financiare nga kategoria rezerva.
10. Të ndryshme.

Drenas, 20.07.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 01-060/24-3705 dt. 20.07.2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **24.06.2022**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 30.05.2022.
2. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën, 2022-2030.
3. Propozim Vendim për Kornizën afatmesme bugetore 2023-2025.
4. Propozim Vendim për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” SHA në Drenas-Glllogoc.
5. Raporti i zbatimit të Planit zhvillimor Komunal 2020-2028.
6. Raporti i auditimit të Komunës së Glllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31, dhjetor 2021.
7. Të ndryshme.



Të premten është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 7 pika për rend dite.

Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, Xhavit Drenori, zyra e informimit.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal, ku theksoj se u shtua në rend dite edhe Raporti i auditimit të Komunës së Glllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31, dhjetor 2021.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 30.05.2022.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Gllgocit për periudhën, 2022-2030.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, plani zhvillimor komunal, harta zonale dhe planet tjera, si dokument bazë i zhvillimit të komunës tonë për vitin 2022-2030 ka filluar me 10.12.2019, komuna jonë me miratimin e hartës zonale të komunës së Drenasit kompletton legjislacionin në fushën e planifikimit hapësinor si harta zonale, planifikimi zhvillimor komunal dhe planet rregulluese të hollësishme të bazuara në ligjin e planifikimit hapësinor. Me miratimin e hartës zonale të komunës së Drenasit do të nisim ndërtimet të ulta të mesme dhe të larta në qytetin e Drenasit. Ne kemi punuar se bashku me Gizin Gjerman dhe me ministrinë për t'i dhënë një hartë sa ma të mirë komunës tonë, kemi pas debate në qdo vendbanim por edhe në sallat e komunës tonë, unë e di që nuk është harta ma e mira e mundshme, komuna jonë ka specifika të ndryshme, një nga problemet më të mëdha që e preokupon për ta bërë një hartë zonale të pranueshme për të gjithë është sepse ne jemi një zonë ku toka bujqësore është e identifikuar ose është nën komasacion ku ne kemi probleme të mëdha që ky komasacion ka filluar në vitet 84-87 dhe sot 2022 ende nuk është zgjidhë, kemi zona në komasacion do duhej të lirohet nga ajo përgjegjësi sepse nuk ka kushte më me u zhvillu bujqësia në zona të caktuara ku konsiderohet që është në komasacion. Ne kemi provu me i dhënë komunës një hartë ku edhe zhvillimi ekonomik me pas perspektiven e vet, kemi bërë qmos që me e ngrit koeficientin e ndërtimit sepse ka ngrit shumë probleme, kom bërë përpjekje me e bërë koeficientin 5 në zonën e parë në Drenas dhe kam bërë përpjekje me e hap hartën sa ma shumë në komunën tonë por na ka kthi ministria dhe e kemi marrë pëlqimin e asaj që sot e keni para vete dhe ju ftoj ta votoni këtë pikë të rendit të ditës, sepse duke votuar i hapin rrugë komunës sonë.

Arbër Halilaj, Komuna e Drenasit e ka hartuar Draftin final të Hartës Zonale të Komunës, që sot e kemi pikë të rendit të ditës dhe unë dola në foltore për të theksuar së pari rëndësinë e këtij dokumenti dhe për t'i theksuar disa çështje rreth HZK-së.

Përgatitja e një HZK-je është obligim ligjor për secilën komunë. Për të përgatitur HZK-në nevojiten përgatitje paraprake, diskutime të detajuara ndërmjet drejtorive dhe autoriteteve përgjegjëse komunale për planifikim dhe menaxhim hapësinor, si dhe përfshirja e qytetarëve duke marrë opinionin e tyre gjatë gjithë procesit të hartimit të HZK-së. HZK është dokument i planifikimit hapësinor, i cili përcakton rregullat për shfrytëzimin dhe zhvillimin e tërë territorit të Komunës sonë, duke bashkëvepruar me Planin Zhvillimor Komunal të miratuar më herët. Njëkohësisht HZK ofron informata për qytetarët, se si mund t'i shfrytëzojnë dhe zhvillojnë pronat e veta. Harta e re zonale zgjidh problemet e pronës përmes përcaktimit të skenarëve dhe kahjeve zhvillimore të qytetit, duke implementuar zgjidhjet nga ana e profesionistëve të fushës, kërkesat ligjore e rregullative si dhe sugjerimet e kërkesat e qytetarëve nga diskutimet publike të organizuara më herët. HZK përcakton masat e veprimt dhe hapësirat për zhvillim ekonomik, bujqësor, urban, komercial, industrial, mbrojtjen e monumenteve kulturo-historike, zhvillimin e turizmit etj. Pra, Komuna jonë po kompletohet me dy dokumentet më të rëndësishme, Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës.

Si përfaqësues i GREEN për Drenas, do të doja të konstatoj që HZK duhet ta ketë si synim që të rris zonat e gjelbërta, sipërfaqet me drunjë urban, shëtitoret dhe infrastrukturën tjetër rekreacionale për qytetarët, duke ulur Indeksën e Ndërtimit, duke siguruar qasje të lehtë në rrugët hyrëse dhe dalje nga qyteti dhe duke e rritur kështu kualitetin e jetës së tyre në Drenas. Me hartën zonale duhet të eliminohet mundësia e vendimeve arbitrare që i vendosë pronat e qytetarëve nga Zona e Ndërtimit në Zonë të Gjelbërt, ose anasjelltas i redukton Zonat e

gjelbërta dhe ato publike-rekreacionale në favor të zonave të ndërtimit për interesa individuale. Unë personalisht dhe GREEN për Drenas jemi për ndërtimin dhe zhvillimin e qytetit, për investime në infrastrukturë e ndërtim, për rritje të sipërfaqeve të gjelbërta e parqeve për rekreacion të qytetarëve, por duke mos favorizuar interesat e oligarkëve të ndërtimit në dëm të interesit të përgjithshëm të qytetarëve të Drenasit.

HZK do të duhej të respektoj në plotni të drejtën e patjetërsueshme të pronës si e drejtë elementare e njeriut, e jo të krijohen presedane dhe me vota të shitura të zhvlerësohen e “konfiskohen” prona, siç ka ndodh me vendimin për shpronësim në qendrën e Drenasit, pa iu dhënë zgjidhje të drejtë banorëve. e duke e pasë të vetmën përgjigje “drejtohuni gjykatës”. Në vendet ku nuk ka drejtësi, njerëzit më së shpeshti thirren në gjykata dhe ligje. Shpronësimi i drejtë meter për meter sipërfaqeje, këmbimi si dhe përfshirja në koeficiente të ndërtimit në marrëveshje me investitorët janë disa prej zgjidhjeve që duhet t’iu bëhen nga Komuna çdo banori që i merret e “drejta e pronës”. Pra, në themel të HZK duhet të qëndrojnë parime të forta të respektimit të pronës private, mjedisit jetësor dhe zhvillimit ekonomik. Qytetarët të vendosen në kushte të barabarta përpara zhvillimit të komunës dhe në asnjë rast të mos lejohet që e drejta legjitime e dikujt për investime të cenohet të tjerët.

Sipas HZK që është përpiluar, shihet që në të gjitha rastet sipërfaqja e ndërtimit do të shoqërohet me 30-50% sipërfaqe të gjelbërta, pastaj ka hapësira për rrugë dhe shërbime të tjera publike, që e vlerësoj. Po ashtu, janë paraparë bonuse të zonimit për Zonat me dendësi të mesme dhe të lartë të banimit, por nuk janë definuar saktë se cilat janë ato bonuse. Po ashtu, ulja e Indeksit të ndërtimit është një element pozitiv në favor të hapësirave gjelbëruese, rekreative, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike.

Kjo HZK duhet t’i jep njëherë e përgjithmonë fund zhvillimit kaotik të Drenasit, ku ndërtimet që janë bërë ishin kryesisht ndërtime të pallateve shumëkatëshe që shpërfillin ambientin përreth, që shfrytëzojnë 90% të parcelës për ndërtim, duke reduktuar hapësirat publike, duke cenuar infrastrukturën rrugore, duke mos pasur parkingje të mjaftueshme – së paku një parking për njësi banesore dhe duke mos lënë asnjë sipërfaqe për zhvillimin e institucioneve sociale e arsimore.

Në çdo rast, HZK dhe zhvillimi i pronës e ndërtimit në Drenas duhet të shoqërohet me përcaktimin e hapësirave për rrugë, institucione arsimore, çerdhe e kopshte fëmijësh, hapësira rekreative, kënde të lojërave e sipërfaqe të gjelbërta kompakte. Hapësirat e gjelbërta dhe ato rekreative, të përcaktuara mbi bazën e standardeve mjedisore, duhet të planifikohen në të gjitha zonat e studiuar. Në HZK ceket Brezi i Gjelbër, për çka më vjen mirë dhe këtë përmbajtje e kemi të elaboruar detalisht në planprogramin e punës së Iniciativës sonë, por në HZK do të duhej të elaborohej në më shumë detaje, jo vetëm si Brez i gjelbërt përgjatë rrugëve dhe shtigjeve, infrastrukturës rrugore kombëtare dhe lokale si dhe vend parkingjeve. Brezi i gjelbërt duhet të rrethojë zonën industriale me një përmbajtje specifike të definuar qartë, që do t’i shërbente së pari mbrojtjes së ajrit nga ndotja dhe pastrimit të tij, duke pasë për bazë afërsinë e kësaj zone me ndotje industriale me vet qendrën e qytetit. Brezi tjetër i domosdoshëm do të ishte brezi i gjelbërt urban, jo vetëm përgjatë rrugëve e shtigjeve dhe për qëllimin që ceket në HZK, por duke e definuar një përmbajtje rekreative, sportive dhe shoqërore të detajuar mirë, që do ta rriste kualitetin e jetës së qytetarëve të Drenasit.

Shpresoj që qytetarët e Drenasit, sidomos ata që kanë interes por edhe probleme që lidhen me pronat e tyre, të kenë qenë pjesëmarrës aktiv të dëgjimeve publike, në mënyrë që Harta Zonale që po vendoset për miratim t’i zgjidh problemet e tyre, duke qenë dokumenti më i rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të Komunës.

Duke e ditë që nga vendimi për fillimin e hartimit të HZK e deri sot, ka kaluar një kohë e gjatë, mbi 3 vite dhe duke pas parasysh që është proces i mundimshëm e me shumë angazhim të resurseve profesionale njerëzore, materiale e konsulenca të ndryshme multi sektoriale, që përpunojnë një numër të madh dokumentesh tekstuale, hartografike, fotografi e grafikone, ne

kemi një informacion të mangët të materiali i kësaj seance me vetëm një Raport më shumë fotografik nga Hapja e shqyrtimit Publik, punëtoritë dhe dëgjimet publike, që do të duhej të mbaheshin në çdo fazë të hartimit të HZK, e që nuk e shoh se janë mbajtur përgjatë secilës fazë dhe nuk kemi procesverbal se çka është diskutuar nga ana e qytetarëve, çka është marrë në konsideratë e çka jo nga komentet e tyre.

Kjo veçmas kur dihet se HZK përfshinë shumë aktivitete e hapa, siç janë: punët parapërgatitore, zhvillimi i diskutimeve publike me banorët në çdo fazë, përfshirja e kërkesave të tyre në procesin e planifikimit, përgatitja e kushteve zhvillimore nga Grupi Punues për infrastrukturën teknike, publike-sociale, rrugore, Plani i veprimit dhe zbatimit, Vendimi dhe realizimi i Shqyrtimit Publik e deri tek harmonizimi i HZK me vërejtjet, komentet dhe sugjerimet. Një kërkesë të një qytetari gjatë debateve e cila ka të bëjë me ndërrim destinimi të tokës bujqësore, që atëherë e kishit refuzuar, tanimë ne e kemi aprovuar në seancën e kaluar, që nuk e di a ka pas të drejtë atëherë kur është refuzuar apo çka ka ndryshuar që e kemi aprovuar tani.

Duke pas parasysh rëndësinë e Hartës dhe faktin që aprovohet për 8 vitet e ardhshme 2022-2030, por edhe jo transparencën dhe informimin e mangët sidomos për ne asamblistët e kësaj legjislature, pata kërkuar në KPF që Grupi Punues të përpilojë një Raport gjithëpërfshirës për çdo fazë të HZK si dhe për realizimin e hapave që i theksova më parë, e deri në atë Raport informues kërkoja që këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjme deri në seancën e ardhshme të Asamblesë, me qëllimin e vetëm të informimit tonë më të detajuar me ecurinë që e ceka më herët. Edhe ashtu jemi nga komunat e fundit që e miratojmë HZK-në, prandaj nëse duhet të votohet gjithçka që hudhet në votim dhe të kryhet shpejt e shpejt procesi, unë do ta kundërshtoj duke votuar kundër.

Nuk jam kundër HZK si të tillë, përkundrazi, por si parim jam që të kemi sa më shumë informacione shtesë për Asamblenë, meqë është punuar gjatë një legjislature tjetër, e pas një informimi të detajuar që tani nuk e kemi, procedimi për votim do të ishte më i arsyeshëm.

Florentina Elezi-Veliu, sot jemi duke diskutuar një temë shumë të ndjeshme por edhe të rëndësishme për qytetaret e Drenasit, unë i kam disa pyetje, e para edhe për nivelin e ndërtimit të mesëm në Komoran është harta 19, faqe 119 vetëm një pjesë e vogël në Komoran është parapare ndërtimi i lartë kurse pjesa tjetër ndërtim i ulët, a mund të na sqaroni nëse vetëm ajo pjesë i përmbushë kriteret për ndërtim të mesëm, tjetra është që i përmendi kolegu paraprakisht për bonuset e ndërtimit a mund të na sqaroni bonuset e ndërtimit përmend ne dokumente po nuk janë sqaruar çka përfaqësojnë dhe si duhet përdoren? Tjetra në hartën zonale kapitulli 5.13 faqe 125 thuhet Pavarësisht që etazhiteti maksimal i kësaj tërësie sipas PRRU-së ka qenë P+7, në realitet ndërtimet e larta të objekteve të banimit janë realizuar në etazhitet prej P+12. Me HZK është parapare të bëhet ri zhvillim i disa blloqeve ku ISN maksimal është 5. Varësisht prej ISN-së të përcaktuar në blloqet përkatëse, kërkohet që zhvilluesi i projektit të paraqes një zgjidhje ideore urbanistike në përputhje me kushtet e përcaktuara me HZK. Cilat janë zonat ku indeksi i ndërtimit ISN parashihet me qenë 5 sepse ne hartë nuk e pash dikun që është specifikuar dhe si do të përcaktohen këto zona ku ka me qenë indeksi 5. Për tokat e komasacionit dhe ndërtimet pa leje e kemi marrë si shqetësim të gjithë cili ka qenë komunikimi në nivelin qendror dhe si do të bëhet zgjidhja e këtyre ndërtimeve pa leje që janë në vazhdimësi e sipër? Që pesë vite qyteti ka pas ngecje nuk ka pas as ndërtime as asgjë që 5 vite është zvarrit kjo pikë e rendit të ditës ndërsa tani sikur po nxitojmë shumë për ta bërë, edhe çka pash në këto harta që janë favorizuar disa persona janë vetëm një grup i caktuar i njerëzve të cilët do të përfitojnë ndërtime e që vota ime është kundër derisa në këtë qytet ka vetëm një grup i njerëzve që favorizohen ndërsa të tjerët diskriminohen.

Egzona Tërdevci, në hartat zonale ceken se janë tri lagje jo formale Lagjja Roga, Lagjja Ferronikeli dhe Lagjja e Re- Komoran, cili është plani i Komunës së Drenasit lidhur ne këto lagje nga ajo çka kam lexuar nga dokumenti këto lagje as nuk i posedojnë pronat, me një far forme janë banues ilegal të asaj zone, nga shqyrtimi publik i hartave zonale janë paraqitur 36 kërkesa për tu përfshirë në këtë dokument për t'i lejuar ndërtimi nga këto 36 kërkesa janë aprovuar vetëm 10 prej tyre. z.Naim Bazaj ka bërë kërkesë që t'i lejohej ndërrimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, vitin e kaluar e ka dhënë komuna arsyetimin se nuk mundet t'ia aprovoj këtë kërkesë pasi që nuk e lejon kufiri ndërtimor që është në plan zhvillimor komunal për vitin 2020-2028 po para një muaji e ky kuvend komunal e ka miratuar atë kërkesë, a keni qenë gabim atëherë, a jeni gabim tani apo kanë ndërruar pazaret?

Zeqir Hasi, përfundimi i hartës zonale dhe miratimi nga Ministria është lajm i mirë për të gjithë qytetaret e Drenasit, me këtë mendoj se qyteti merr pamje të re, po ashtu me këtë dokument strategjik duhet të sigurohet edhe shfrytëzimi i përshtatshëm i tokës mirëpo i kam disa vërejtje në këtë hartim të hartës zonale, mendoj se nuk e ka shtrirjen më të mirë të mundshme harta zonale unë mendoj se harta në shtrirje ka shumë degëzime për çka edhe unë i kam shqetësimet e mia për zhvillimin e qytetit në mënyrën me të mirë të mundshme, mendoj se kjo hartë duhet të votohet edhe me këto defekte që t'i hapin rrugë zhvillimit të Drenasit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, çdo propozim të mirë që e keni unë jam i gatshëm me akceptu dhe me e fut në funksion atë problem. Sa i përket pronës së Naim Bazës një herë ka ardh në kuvend dhe është votua, prej viteve të 70- ta kur është ndërtuar rruga ka qenë zonë ndërtimore ka qenë minierë e gurit dhe akoma është po e njëjta, çdo qytetari që ju ka ndërruar destimi i pronës ju ka ndërru mbi bazën e një vendimi askush nuk mund me ndërru vendime pa i kompletuar gjitha dokumentacionet. sa i përket ndërtimeve të mesëm në Komoran ne kemi vepru ne bazë të ligjeve aktuale të Kosovës në pajtueshmëri me ministrinë e ambientit ajo e ka leju aq sa e ka leju në komoran aq e kemi fut në zonën e ndërtimit, sa i përket bunuesit të ndërtimit për bonuese nuk ka ligj por që ka rregullore dhe ju keni me pas komisionin që do ta miratoni vet. Etazhitetet nëse dikush e ka gjysme hektar tokë ndërtimore mundet me maru 25 kat nëse don por e ngushton objektin dhe e ndërton në lartësi sepse nuk ka me pas kufi a ka me qenë 5,6,7 kat a 10 kat por koeficienti caktohet mbi bazën e përqindjes të pronës në tokë. Lagjen e Feronikelit nuk mundemi me e zgjedh ne, e zgjedh vetëm qeveria që është në nivel qendror është pronë e tjetër kujt dhe kane ndërtu njerëzit në pronë të huaj, ato shtëpi me ligjin e planifikimit hapësinor rrinë në pritje pra nuk ia rrezon askush, atë çështje e zgjidh niveli qendror nuk është kompetencë e jona nuk mundemi me e zgjidh. E ceket se janë bërë 36 kërkesa për ndërtime janë dhënë 10, kërkesa mundemi me bërë mirëpo kërkesa që i plotëson kriteret ligjet aprovohen. .

Egzona Tërdevci, lidhur me pyetjen për z.Bazaj nuk mora përgjigje të qartë, nëse kanë qenë disa kërkesa për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore vitin e kaluar në mesin e të cilave ka qenë edhe kërkesa e z.Bazaj të gjitha janë refuzuar me argumentin se janë përtej kufirit ndërtimor nga plani zhvillimor 2020-2028, a mundemi me i besu vlerësimit të atij komisionit kur e njëjta kërkesë tash po aprovohet dhe nëse vlen e njëjta a mundemi me ju thënë atyre qytetareve hajdeni bini kërkesat në kuvend komunal se Naim Bazajt ia kem kalu ia kalojmë edhe juve.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, asnjë leje ndërtimore nuk ka marrë Naim Bazaj, ndërrim destinimi dallon me marrjen e lejes ndërtimore, edhe mos me e bërë ndërrimin e

destinimit e kap harta ku nuk kemi pas komasacion për gjatë rrugës regionale e kemi hap kufirin 200 m. Kemi vepru ashtu siç duhet me vepru.

Arbër Halilaj, nënryrën e zbatimit të HZK-së do ta shohim tani e tutje në vazhdimësi se si i orienton nevojat e qytetareve.

Albulena Saliuku, sot e kemi një pikë të rendit të ditës që është shumë e rëndësishme, nëse duam të vazhdojmë përpara për të mirën e qytetareve dhe të komunës tonë kërkoj sot që të jemi unik të gjithë dhe ta votojmë hartën zonale.

Valentina Leku, Drenasi si një qytet i cili ka ngecur në ndërtimet e larta dhe kjo është një nder arsytet se pse qytetarët ekin nga Drenasi, pra Drenasi i pazhvilluar pa ndërtime për të cilin e kemi fajësua gjithë kryetarin edhe unë personalisht mirëpo në realitet është një ligj që nuk ka kaluar në asamblenë e kaluar, sot ajo assemble nuk është por është Drenasi me vite mbrrapa pa ndërtime, nuk po i bindjet e askujt unë e mbështes këtë ligj gjithashtu lus të tjerët që ta mundësojnë ta votojnë përmes kuvendit ta shohim qytetin tonë duke u ndërtuar.

Labinot Halilaj, në hartën zonale u dashtë me u diskutua vetëm çështja e ndërtimit, u dashtë me u diskutua edhe çështja e zonave industriale, me u diskutua edhe çështja e zonave bujqësore, me u diskutua çështje në zhvillimin e qytetit, në harta zonale edhe planifikuar edhe një zone e re ku është zona e ciklisteve, harta zonale mirë që ka ardhë në kuvend, kërkoj që të votohet kjo pikë e rendit të ditës.

Beqir Kiqina, sa i përket hartës zonale si përfaqësues i AAK-së në Kuvendin Komunal parimisht jam për, por dua të laburoj dhe të pranoj faktin se në mandatin e kaluar përkatësisht unë kam qenë kritik në këtë kuvend komunal drejtuar kryetarit dhe do të jem përsëri kur është interesi i përgjithshëm i qytetareve, në të gjithë e kemi kritikuar qasjen e kryetarit i cili ka ndaluar shumë veprimtari ndërtimore në Komunën e Drenasit dhe kemi kërkuar që komuna jonë të zhvillohet dhe të vazhdojë tutje, pasi që kjo hartë zonale përfshinë ndërtimet e vogla, të mesme dhe të larta dhe ju mundëson njerëzve që merren me biznes dhe të hapin sa ma shumë vende pune atëherë të gjithë jemi për, pasi kam shikuar këtë propozim të hartës zonale dhe ka zona bujqësore të cilat nuk cenohen, do të ketë edhe zona industriale dhe lejohen zonat ndërtimore dhe ka hapësira të gjelbërta mendoj se kjo hartë rrjedhimisht plotëson kriteret dhe besoj se duhet të kalohet, nuk është më e mira por për të mirën e qytetareve dhe për t'i lejuar bizneset të cilat kanë ngec unë jam për.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 23 anëtar, 5 kundër, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për Kornizën afatmesme buxhetore 2023-2025.**

Drejtori i Financave- Shyqiri Bublaku, sa i përket kornizës afatmesme buxhetore në si drejtori e financave e kemi përcjell edhe qarkoren buxhetore në bazë të cilës janë caktuar edhe kufijtë fillestar për buxhetin e komunës për vitin 2023 dhe parashikimet provuese për vitin 2024-2025, buxheti i vitit 2023 për Komunën e Drenasit parashihet të jetë 18,156,892€ ku në këtë shumë bënë pjese edhe shumë për investime kapitale në vlerë prej 6,335,649 €. Si kuvend komunal kemi shfrytëzo mundësitë që me qarkoren buxhetore është paraparë që shuma e investimeve kapitale të jetë 29 % e shumës totale kemi shku prej 34.67 %. Për vitin

2024 projekcioni provues është 7,167,087 €, ndërsa shuma totale e buxhetit është 9,421,386 €, ndërsa në vitin 2025 projekcioni provues është 7,782,667 € për investime kapitale ndërsa shuma totale e buxhetit është 20,191,418 €.

Egzona Tërdevci, Unë kam marrë pjesë në dy nga tri dëgjimet publike që kanë qenë, ditën e parë kur kam marrë pjesë në dëgjime publike në Kuvend Komunal shumica kanë qenë zyrtar të komunës nuk ka asgjë të keqe që zyrtaret komunal me qenë pjesë e dëgjimit publik po e halli është që qytetaret nuk po janë pjesë e dëgjimeve publike në fshatra ka qenë gjendja me e mire, unë për këtë nuk po e fajësoj komunën, ju ftoj secilin me u angazhu dhe me i informua qytetaret kur ka dëgjime publike, sepse për ekzekutivin është e rëndësishme me i dëgjua kërkesat e qytetareve sepse kërkesat e stafit te vet mundet me i marrë qdo ditë.

Lexoj kërkesën nga administrata e fshatit Llapushnik kjo kërkesë është bere me dt. 21.06.2022 për kryetarin Ramiz Lladrovci, kryesuesit Milaim Hajdari dhe asamblistët e kuvendit. I nderuar z. Lladrovci e z. Hajdari, asamblistë, pas dëgjimit publik dhe objektivat me prioritet të investimeve infrastrukturore nëpër fshatra dhe në fshatin tonë Llapushnik, me pastaj administrata e fshatit ka mbajt takim dhe nga ky takim kemi dal me kërkesë që rruga të cilën e keni fut në prioritet Llapushnik – Berishë ta anuloni në këtë fazë, pasi që ka kosto të lartë përderisa në Llapushnik ka ende rrugë të pa asfaltuara dhe lagje e shtëpi pa kanalizim megjithatë pa asfaltim e kanalizim është edhe shkolla “Hasan Prishtina” teksa rrezikohet jeta e shëndeti i nxënësve dhe stafit në shkollë po ashtu edhe i banoreve përreth saj. Llapushniku si një nder fshatrat që më se shumti e mbush buxhetin e komunës nuk ka as sistem të ujit të pijes e as sallë për rekreacion për të rinjë, ndërsa si fshat meritur nuk ka asnjë investim nga komuna të paktën tri shkronja UÇK. Edhe pse administrata e fshatit nuk është ndalur me kërkesë edhe atëherë kur nuk e kishim mbështetjen nga qeverisja e z. Lladrovci për realizimin e kërkesave ndërkaq në kontekstin e punësimit të rinjtë e këtij fshati po e braktisin vendin nga mungesa e punësimit dhe perspektives në mungesë të investitorëve vendor dhe të huaj në Komunën e Drenasit, prandaj duke shfaqur këtu të gjitha argumentet kërkojmë që rruga Llapushnik-Berishë të anulohet në këtë fazë në mënyrë që t’i hapet mundësi investimeve të lartcekura dhe të domosdoshme në fshatin Llapushnik, duke besuar në qasjen tuaj pozitive presim edhe përgjigje të pranueshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kërkesa si ajo e tillë që e ka dërgua e që nuk është administrata e fshatit nuk kanë asnjë vlerë, takimet pa përgjegjës të debateve janë pa vlerë. Sa i përket kanalizimit e kane pengu vet ata te cilët edhe po flasin.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, 2 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” SHA në Drenas-Gllogoc.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti i zbatimit të Planit zhvillimor Komunal 2020-2028.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Raporti i auditimit të Komunës së Glllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31, dhjetor 2021.**

Arbër Halilaj, Sa i perket Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2021, ky shtjellon mënyrën eshfrytëzimit të burimeve financiare të Komunës sonë dhe pajtueshmërinë e proceseve dhe transaksioneve të kryera gjatë ekzekutimit të buxhetit, në raport me legjislacionin në fuqi.

Dua të përgëzoj Drejtorin Bublaku dhe gjithë ekzekutivin e zyrtarët komunal, Kryetarin Lladrovci si përgjegjës për buxhetin dhe mbikëqyrjen e raportimit financiar, për një Raport me pak gjetje e lëshime dhe për një konstatim të përgjithshëm të auditorit se përdorimi i burimeve financiare dhe transaksionet për ekzekutimin e buxhetit kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e auditimit.

Megjithatë, tek Baza për konkluzion janë dhënë edhe disa gjetje dhe vërejtje, siç janë:

- Pagesa të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore ishin në vlerë prej 595,988€, prej tyre shpenzimet shtesë për procedura përmbarimore ishin në vlerë prej 148,176€, që mendoj se janë shuma të mëdha dhe krijojnë kosto shtesë të madhe për një komunë si Drenasi;
- Angazhimi i stafit për punë dhe detyra specifike pa procedura të prokurimit;
- Mangësi në procedimin e pagesave, përkatësisht zotimi i mjeteve pas pranimit të faturave;
- Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor;
- Mos respektim i kriterëve gjatë vlerësimit të aplikacioneve të përfituesve të subvencioneve – është çështje brengosëse, sepse dëmton kredibilitetin e Komunës dhe krijon presedan të keq të mosrespektimit të kriterëve në thirrjen publike.
- Mungesa e projektit ekzekutues në specifikat teknike të tenderit – që është gjetje e përsëritur.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti **llogaridhëniën dhe transparencën**, sidomos atë buxhetore, që unë i konsideroj kushte të domosdoshme në punën e një Komune. Këto pastaj ndikojnë direkt në rritjen e besimit të qytetarëve për përdorimin korrekt të burimeve financiare, duke e rritur kështu edhe besimin në qeverisjen lokale.

Raporti që kemi para vetes përmban 13 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Pyes drejtorin Bublaku ose Kryetarin se çfarë do të ndërmerri sidomos tek rekomandimet e përsëritura që janë (4), e që rrjedhimisht si gjetje të përsëritura për mua kanë rëndësi dhe prioritet.

Egzona Tërdevci, dua të ndalem të disa gjetje të gjetja e parë raporti i auditimit thuhet se pagesa për vendime gjyqësore përmbarimore janë realizuar nga kategoritë e gabuara si nga paga e mëditje, investime kapitale, kategoria e mallrave dhe shërbimeve, mua me shqetëson më shumë realizimi i pagesave gjyqësore nga investimet kapitale pasi që kjo ka shkuar në dam të qytetarëve duke ia pamundësuar implementimin e projekteve që janë në interes të tyre, potencialisht me aq sa kam përvojë nga prokurimi publik një lagje ka mbet pa ujësjellës pa kanalizim apo asfalt për shkak të keq menaxhimit që është bërë nga këto pagesa, tek gjetja e dytë është angazhimi i stafit për punë dhe detyra specifike pa procedura të prokurimit janë


angazhuar 6 zyrtar për katër muaj në Drejtorinë e Kulturës të njëjtin kanë nënshkruar kontrata kundërligjshëm duke shkel ligjin për prokurim publik, në arsyetimin nga komuna thuhet se kjo ka ndodhur për shkak të mungesës se njohurive për procedurat ligjore, si ka mundësi që një komunë që thirret vazhdimisht në ligj të mos i njeh disa procedura të thjeshta të prokurimit apo ndoshta ka ndikuar fakti që ka qenë vit zgjedhor dhe është dashur t'i kryej favore për t'i mbajtur militantet partiak, a janë marrë masa ndaj atyre që kanë marrë këtë vendim të dëmshëm për komunën, a ka marrë përgjegjësi kush që bie ndesh me ligjin? Tek gjetja e tretë ka mangësi në realizimin e pagesave se paku 5 raste fatura se bashku me situacione janë pranuar para se të bëhej kërkesa për zotimin e mjeteve, kjo mund të ndikoj në mos pagimin e obligimeve në kohë duke shkaktuar shumë ngarkesa në menaxhimin e buxhetit komunal, a po i nënshtroheni presionit nga operatorët ekonomik apo është çështje neglizhence e mos menaxhimit siç duhet i financave publike? Na duhet një sqarim nga Drejtoria e Financave lidhur me këtë gjetje, prap është gjetja dhe mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor por më shqetësuesja prej gjithave është mungesa e projekteve ekzekutuese, sipas udhëzuesit operativ për prokurimin publik kërkohet që komuna para se të shpall tenderët tek investimet kapitale ku kryhen punë duhet të ketë projekt ekzekutues nga raporti i auditimit del e të paktën tre kontrata nuk kanë pas projekt ekzekutues kur janë shpallë tenderët për ato punë, ndërsa në arsyetimin që e ka dhënë komuna thuhet se nuk ka pasur buxhet për të angazhuar operator ekonomik për hartim të projekteve por kjo e dëmton rend cilësinë e investimeve kapitale pasi që kryerja e punëve vetëm në bazë të paramases dhe paralogari së mund të paraqes pengesa të shumta duke shkaktuar vonesën e punimeve apo edhe rritjen e kostos se projekteve ky ka qenë edhe rekomandim prej viteve të kaluara ende nuk ka fillu zbatimi i tij a mund të evitohet përsëritja e këtij gabimi për vitin 2022.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, auditori ka dhënë një opinion ma të mirin dhe nuk i kanë komunat e tjera të Kosovës, rekomandimet dalin si derivat i rekomandimeve për pagesat gjyqësore ose përmbarimore, pagesat gjyqësore janë mëditjet e mësimdhënësve, për shujta për paga jubilarë për paga përcjellëse etj.

Meqë tek të ndryshmet nuk pati diskutime, kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 12:00 min .


Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 24.06.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
ZYRA E KRYETARIT



01 Nr. 052/01-34373

Dt. 08.07.2022

RAPORTI FINANCIAR JANAR - QERSHOR 2022

KORRIK 2022

1. Hyrje

Raporti financiar buxhetor, për periudhën janar – qershor 2022, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës, mbulon periudhë janar – qershor të vitit fiskal dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet buxheti fillestar i Komunës për vitin 2022, sipas kategorive ekonomike të shpenzimit.

Tabela Nr.1 Buxheti Komunal sipas Ligjit Nr.08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Përshkrimi	Buxheti	Pagat	Mall e shërb	Komunalit	Subvenc	Kapitalet	Nr.punt
Z.Kryetarit	212,941.00	156,956.00	48,985.00	-	7,000.00	-	19
Adm.person	396,563.00	234,863.00	131,700.00	-	-	30,000.00	42
Inspektorati	108,455.00	68,240.00	40,215.00	-	-	-	10
Z.Kuvendit	156,330.00	109,380.00	46,950.00	-	-	-	
Buxhet dhe finan.	121,190.00	103,190.00	18,000.00	-	-	-	16
Shërb Pub. Em.	938,186.00	163,309.00	292,269.00	145,008.00	90,000.00	247,600.00	25
Infrastruk Publike	2,715,516.00	49,510.00	25,879.00	-	-	2,640,127.00	8
Z.K.Kthim	8,486.00	7,956.00	530.00	-	-	-	1
Bujqësia	138,140.00	75,813.00	12,327.00	-	50,000.00	-	13
Planif.Zhvill.Ekon.	95,341.00	48,741.00	23,600.00	-	23,000.00	-	8
Gjeodezi dhe Kad.	494,809.00	83,731.00	11,078.00	-	-	400,000.00	13
Urbanizmi	106,215.00	47,798.00	18,417.00	-	-	40,000.00	8
Administrata Sh.	113,721.00	36,381.00	52,340.00	-	25,000.00	-	5
Kujd.Prim.Shënd	2,088,614.00	1,297,624.00	414,134.00	54,000.00	-	322,856.00	181
Shërb Sociale	114,167.00	91,503.00	16,713.00	5,951.00	-	-	14
Kultura dhe sporti	534,869.00	74,920.00	89,949.00	-	125,000.00	245,000.00	13
Adm. Arsim	807,268.00	76,755.00	228,513.00	-	100,000.00	402,000.00	12
Ars.Parafillor	173,010.00	119,979.00	46,482.00	6,549.00	-	-	22
Ars. Fillor	5,061,392.00	4,562,216.00	434,176.00	65,000.00	-	-	740
Ars. I Mesem	1,460,878.00	1,291,135.00	147,743.00	22,000.00	-	-	177
Totali I Buxhetit	15,846,091.00	8,700,000.00	2,100,000.00	298,508.00	420,000.00	4,327,583.00	1,327

1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar gjatë këtij tremujori. Të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rënie prej 5.32 %, që korrespondon me shumën prej: 64,367.47 € më pakë se plani gjashtëmujor. Kjo rënie është e ndikuar nga vendimi për heqjen e vertetimit për regjistrimin e automjeteve e që ka ndikuar drejtpërdrejt në inkasimin e të hyrave komunale, dhe gjendja ekonomike e krijuar cila po percjell gjithë botën. Por të hyrat direkte dhe indirekte të komunës për periudhën raportuese kanë arrit shumën prej 1,045,483.49 apo 86.40 % të planit vjetor ketu kanë ndiku Granti i performancës me shumë prej: 504,857.96 ,Gjobat e Komunikacionit me shumë prej: 189,313.96 si dhe gjobat e gjykatave në shumë prej: 13.110.00 € e për sqarim gjobat e gjykatave dhe komunikacionit akoma nuk na janë alokuar për tre muajt e dytë e që pritet të na alokohen (ndahen) në ditët në vazhdim.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore për këtë periudhë kanë arritur në shumë prej: 6,807,817.78 € përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2022, apo 50.06% të buxhetit të alokuar të komunës për vitin 2022. Ky shpenzim kryesisht është i ndikuar nga ekzekutimi më i lartë i shpenzimeve nga kategoria e pagave dhe mëditje më shumë se viti paraprak kjo ka ardh si shkak i pagesave të shujtav dhe shpenzimeve të udhëtimit. Ndërsa në kategorit tjera kemi një nenshpenzim.

Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën prej 5,408,254.17 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 98.79 % . Krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori . Fatura e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqet një rritje prej 24.33 % apo rreth 1,058,254.17 € më shumë se plani vjetor. Ndërsa krahasuar me vitin 2021 kemi rritje prej:22.29 % apo shuma prej:985,758.95 €.Rritja ka ardh si shkak I pagesave të shujtave,dhe shpenzimeve të ushqimit për dy sektoret (Arsim,Shëndetësi).

Shpenzimet në mallra dhe shërbime Gjatë këtij tremujori vlera e ketyre shpenzimev kanë arrit shumën prej:529,403.37 € dhe kemi një rënje prej 15.32 % krahasuar me vitin 2021,por duhet të kemi parasyshë se buxheti Komunës së Denasit i është alokuar tek në muajin shkurt dhe kjo ka ndikuar që të kemi shpenzim ma të ulët se vitin e kaluar.

Shpenzime në komunal, shpenzimet për këtë kategori kanë shënuar rritje dhe kanë arrit shumën prej: 135,396.40 krahasuar me vitin 2021 kemi një rritje prej: 54,292.84 € apo 40.10 % . Kjo shumë është rrit dhe për arsye të rritjes së objekteve të reja inflacionit si dhe faturave të ndriqimit publik të cilat cilat rrisin koston e shpenzimit.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere, shënuan vlerën prej 79,123.80 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 29.90% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar të kësaj kategori për këtë periudhë. Subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rënje prej 34.62%, krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjte të vitit 2021.

Shpenzimet kapitale janë realizuar me një normë të jo të kënaqshme. Ato arritën vlerën prej: 655,639.94 €, që është 12.94 % e buxhetit vjetor të vitit 2022.Krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2021 kemi rritje të shumës së shpenzuar për 57,952.26 €.Por edhe të kjo kategori kemi vonesa në alokimin e buxhetit të vitit 2022,dhe situatë e krijuar me inflacionin I cili po ndikon në qdo lëmi ekonomike.

Sa i përket buxhetimit gjinor mund të themi se përqindja e femrave në listën e të punësuarve arrin në 43.54 % dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë përqindje të shpenzimit .Gjithashtu komuna ka nda dhe subvencione për organizata jo qeveritare dhe vetëm në Drejtorinë e zhvillimit ekonomik ka nda shumën prej 20,000.00 € e cila shumë ka shkuar 80% në buxhetimin gjinor.

Gjithashtu implikime buxhetore komuna ka pas dhe mbi shpenzim sa i perket dy kontratav kolektive të cilat janë ekzekutuar nga thesari për shujta shpenzime ushqimi dhe udhtimi paga jubilarë paga percjellse dhe shuma për keto pagesa të ekzekutuara nga thesari kap shumën prej:1,228,368.19 €

Të hyrat vetanake për tremujorin e dytë të vitit 2022 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2020	2021	2022	% me 2021
	në Euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	735,713.40	1,094,803.35	1,247,911.35	113.98
1.1. Të hyrat nga kodi 16301	28,270.35	51,026.56	66,541.07	130.40
Taksa për certifikata (50013-50016)	12,729.10	17,014.50	21,817.00	128.23
Vert.Fotok.dokumentacionit (50018)	235.00	320.50	281.00	87.68
Kerkesat 50019	2,150.50	4,472.00	3,819.28	85.40
Të Tjera 50413	-	-	-	-
Qeraja për Objektet Komunale 50408	13,155.75	29,219.56	40,623.79	139.03
1.2.Të hyrat nga kodi 16601	1,504.90	1,706.08	1,370.00	80.30
Të hyra nga Inspeksioni	1,504.90	1,706.08	1,370.00	80.30
1.3.Të hyrat nga kodi 17501	127,464.81	423,974.65	356,147.00	84.00
Tatimi në pronë 40110	192,980.07	375,953.65	302,636.00	80.50
